



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 MARS 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. MARTA 2016. GODINE,**

**MARS - MART
2016**

Rendi i ditës

1. Votimi i Projektligjit nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma,
2. Votimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të Skemës së Ndihmës Sociale për periudhën 2013-2015,
3. Votimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014,
4. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit,
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-064 për patentë-shofer
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-31 për procedurën e përgjithshme administrative.

Dnevni red

1. Glasanje o Nacrt zakona br.05/L-091 o zaštiti od buke,
2. Glasanje o izveštaju Komisije za zdravstvo, rad i socijalna pitanja u vezi budžetskog nadgledanja šeme socijalne pomoći za period 2013 -2015,
3. Glasanje o izveštaju o radu Kosovske agencije za privatizaciju za 2014 godinu,
4. Glasanje o izveštaju Komisije za prava i interese zajednica i povratak u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o selu Velika Hoča i Zakonu o Istorijskom centru Prizrena,
5. Razmatranje preporuke Nezavisnog izbornog organa za imenovanje članova u Bordu Organa za razmatranje javnih nabavki.
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-064 o vozačkoj dozvoli,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-07 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-048 o menadžiranju javnih finansija i odgovornostima,
8. Drugo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-31 o opštoj administrativnoj proceduri.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë,
Kolege deputete,
I nderuar kryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e paraparë nga seanca plenare, e mbajtur më 24 mars 2016.

Derisa të bëhet kuorumi, fjalën për një çështje e ka kërkuar Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala podpredsedniće!
Poštovani premijeru,
Uvaženi kolege poslanici,
Poštovani građani,
Ja bi samo htela da iznosim jednu problematiku koja je u prizrensku regionu, a tiće se vatrogasne službe, i tražimo od ministra Unutrašnjih poslova da obezbedi veći kadar, jer zahteve našeg kraja, grada Prizrena, su veliki.

Takođe ono što se odnosi na moju zajednicu jeste Policijska stanica, koja je trenutno u Sredskoj, a zahtevamo od nadležnih organa, odnosno ministra za Unutrašnje poslove, istureno odeljenje u selu Rečane, kako bi obezbedili sigurno bezbednost i sigurnost tih građana koji žive u Župskoj regiji. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë tani janë 61 deputetë. Rendin e ditës bashkë me materialet e keni marrë.

Fillojmë me pikat e rendit të ditës.

Sa i përket plotësimit të rendit të ditës, për fjalë është paraqitur kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, zoti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit!
Përshëndetje për kryeministrin, ministrat, deputetët,
Desha të kërkoj që jashtë rendit të ditës të hyjë si pikë e pestë përzgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm.

Janë plotësuar kushtet, ndërsa është shtyrë tanimë shumë kohë. Prandaj, kërkoj të kemi mirëkuptim.

KRYESUESI: Zakonisht plotësimet shkojnë si pikë e fundit e rendit të ditës, meqenëse po kërkonin që të jetë pikë e pestë e rendit të ditës duhet deklarimi i grupeve parlamentare dhe deklarimi i deputetëve.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zoti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje kryeministër,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson shumë të rëndësishëm që ta kemi Auditorin dhe i jep përkrahje propozimit të zotit Ali.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet kërkesën që sot të bëhet për zgjedhja e Auditorit, përkatësisht të jetë pikë e rendit të ditës ajo që u propozua nga zoti Ali Sadrija, nënkryetar i Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është. AAK nuk është. Lista serbe ka qëndrim lidhur me këtë? Zoti Simiq, urdhëro!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste podržava predlog da se danas izvrši izbor revizora Kosova. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma” nuk është, Grupi Parlamentar “6+”. Zonja Shinik, urdhëro!

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim! Öneriyi “6+” Parlamenter Grubu da kabul etmektedir.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë është qëndrimi i të gjithëve, besoj që duhet një votim formal për të qenë si pikë e pestë çështja e zgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm.

Kush është për? Kundër? Nuk ka. Miratohet. Me 69 të pranishëm, ka kaluar.

1. Votimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Të nderuar deputetë,

Diskutimi për këtë pikë, si dhe për pikat numër 2, 3 dhe 4 të rendit të ditës së seancës së sotme, ka përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 24 mars 2016.

Mirëpo, gjatë procedimit me votim për pikat e lartpërmendura ka pasur mungesë të pjesëmarrjes së deputetëve. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatohet se me 57 vota për, 6 abstenime dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

2. Votimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen buxhetore të Skemës së Ndihmës Sociale për periudhën 2013-2015

Edhe ky e kërkon një votim. Në sallë janë 71 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Me 66 vota për dhe 2 abstenime Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e buxhetit të Skemës së Ndihmës Sociale për periudhën 2013-2015.

3. Votimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014

Edhe ky është votim për shkak se nuk ka pasur kuorum në seancën e kaluar. Në sallë janë 71 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Me 55 vota për, 5 vota kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014, bashkë me rekomandimet e Komisionit Funkcional. Shpresoj që na vjen edhe raporti i vitit 2015 për ta votuar.

4. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Edhe për këtë vazhdojmë me votim. Në sallë janë 75 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Me 58 vota për, 5 vota kundër dhe 8 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fshatin Hoçë e madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

- Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Rekomandimi i Komisionit bashkë me vendimin e Presidentes u është shpërnda deputetëve.

E ftoj zëvendëskryetarin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, zotin Ali Sadriu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë rekomandimin e Komisionit. Zoti Sadriu, e keni fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë, ministra,

Në harmoni me dispozitat ligjore, meqë Zyra e Auditorit është kategori kushtetuese, pra në harmoni edhe me Kushtetutën, Presidentja e ka zgjedhur një panel prej strukturave të ndryshme, të përbërë prej shoqërisë civile, pjesës akademike, Bankës Qendrore, Kuvendit, e kështu me radhë.

Detyra e këtij komisioni ka qenë që të bëjë standarde mbi të cilat do ta bëjë përzgjedhjen, e ka shpallur konkursin dhe ka zgjedhur në harmoni me kriteret e përcaktuara.

Paneli ia ka propozuar Presidentes tre kandidatë, ashtu siç precizohet edhe në Kushtetutë. Presidentja ia propozon Kuvendit një kandidat të vetëm, dhe ai është Besnik Osmani.

Komisioni e ka miratuar në tërësi këtë raport dhe e propozon të njëjtin në Kuvend, me kërkesë që të votohet zoti osmani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Grabovci, keni diskutim lidhur me këtë çështje? Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet propozimin e Presidentes. Ne e kemi mbështetur këtë propozim edhe në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave dhe i ftoj kolegët deputetë që ta votojnë auditorin, zotin Besnik Osmanin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jep përkrahje rekomandimit të Presidentes së Kosovës dhe njëkohësisht të komisionit përkatës lidhur me përzgjedhjes e zotit Osmani për Auditor të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është, AAK nuk është. Lista serbe, zoti Simiq e keni fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpske liste podržava predlog predsednice Kosova i Komisije da danas izaberemo generalnog revizora. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkan yardımcısı. “6+” Parlamenter Grubu da Cumhurbaşkanının önermiş olduğu adayı desteklemektedir.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, e do dikush fjalën? Nuk do askush. Deputetët, dëshirojnë të diskutojnë lidhur me këtë çështje? Nuk dëshirojnë. Atëherë dua që t'jua tërheq vëmendjen lidhur me këshillat juridike.

Bazuar në nenin 136, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit ose Presidentes në këtë rast të Republikës së Kosovës.

Pra, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet së paku me 61 vota. Ta kemi parasysh këtë të gjithë.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim elektronik për zgjedhjen e zotit Besnik Osmani për Auditor të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Lus deputetët t'i zënë vendet e tyre dhe të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj që më 76 vota për, 1 abstenim dhe 3 kundër, Kuvendi e zgjodhi zotin Besnik Osmani për Auditor të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me mandat 5-vjeçar. I urojmë suksese!

5. Shqyrtimi i rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit

Organi Përzgjedhës i Pavarur për zgjedhjen e kandidatëve për kryetar dhe të dy anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në bazë të nenit 100 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092, në mbledhjen e mbajtur më 25 mars 2016, i ka intervistuar kandidatët e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për kryetar dhe anëtarë të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për emërimin e kryetarit dhe dy anëtarëve të këtij bordi, si në vijim:

1. Blerim Dina, për kryetar,
2. Goran Milenković, për anëtar dhe
3. Nuhi Paçarizi, për anëtar.

Lidhur me këtë, në qoftë se përfaqësuesi i Qeverisë si propozues e dëshiron fjalën? Nuk e dëshiron fjalën askush nga Qeveria. Radha është e përfaqësuesve të partive politike. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'i jap mbështetje zgjedhjes së anëtarëve për Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jep mbështetje përzgjedhjes nga paneli vlerësues dhe rangimin që e ka bërë për besimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, me emrat të cilët u kanë ardhur deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është, AAK nuk është. Lista serbe, zoti Simiq... apo s’dëshiron. Në rregull! “6+”-i nuk është paraqitur. “Nisma” nuk është.

Deputetë, dëshiron dikush të flasë? Nuk dëshiron askush. Përfaqësuesi i Qeverisë, po ashtu nuk dëshiron. Në sallë janë 81 deputetë. Vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e kryetarit dhe të dy anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj që me 64 vota për, 10 abstenime, 1 votë kundër, Kuvendi e zgjodhi Blerim Dina, kryetar; si dhe zotin Goran Milenković dhe zotin Nuhi Paçarizi, anëtarë të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Mandati i të emëruarve është për 5 vjet, pa të drejtë riemërimi.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentë-shofer

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për patentë-shofer dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin zotin Raif Çela, nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Raportin me rekomandime. Zoti Çela, e keni fjalën.

RAIF ÇELA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Projektligji për patentë-shofer, i iniciuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe i proceduar deri më tani në të gjitha procedurat në Kuvend, është sot përpara jush.

Siç e dini, i ka gjithsej 105 amendamente. Pjesa dërmuese e tyre nuk janë përmbajtjesore, por vetëm teknike. Vetë projektligji i sjellë para Kuvendit ka pasur plot probleme të tilla teknike, megjithëse nuk ka pasur probleme profesionale. Po e përsëris, pjesa më e madhe e amendamenteve janë probleme teknike, sepse projektligji i proceduar nga Qeveria nuk u është përmbajtur teknikave të thurjes së projektligjeve, pastaj ka pasur plot probleme në kuptimin e fjalisë, domethënë probleme të sintaksës dhe probleme drejtshkimore. Pjesa e tekstit, të cilin ne e kemi amendamentuar është korrigjuar prej gabimeve të tilla. Pjesa tjetër e tekstit, mjerisht, ka

mbetur e pakorrigjuar dhe mund të hasni edhe në gabime teknike, por që nuk e cenojnë përmbajtjen e projektligjit.

Konsideroj se është një projektligj i cili do të bëhet një ligj i mirë, që do ta bëjë funksionale këtë fushë të jetës. Çështjet përmbajtjesore me të cilat është marrë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe që i ka ndryshuar me propozime për amendamente, janë:

- Niveli i përgatitjes profesionale të punonjësve profesionalë të të gjithë atyre që janë përgjegjës për marrjen e patentë-shoferit, si dhe numri i orëve për përgatitjen praktike dhe teorike të provimit profesional. Komisioni ka qenë unanimit në mendimin se numri i orëve të mbajtura për përgatitjen për patentë-shofer duhet të zvogëlohet, për shkak se numri i orëve kushtëzon edhe çmimin e marrjes së patentë-shoferit.

Duke pasur parasysh këtë fakt dhe duke pasur parasysh se numri i orëve të mjaftueshme që një kandidat të bëhet shofer i mirë është 20 orë teorike dhe 20 orë praktike, ndërsa për kategoritë tjera së paku 15 orë, komisioni në amendamentin 44 ka thënë kështu: “Minimumi i orëve mësimore nga pjesa teorike e aftësimit të kandidatit për kategori është së paku 20 orë, ndërsa për kategoritë tjera së paku 15 orë”.

Për shkak të një gabimi teknik ka rënë një pjesë e tekstit, në të cilin është dashur që edhe për pjesën praktike teksti të vazhdojë kështu. Kjo vlen edhe për nenin 46 për aftësimin nga pjesa praktike, orët nga pjesa praktike të jenë 20 orë, ndërsa për kategoritë tjera së paku 15 orë. E ftoj Kuvendin që t’i miratojë të gjitha amendamentet në tërësi, bashkë me këtë ndryshim të vogël, i cili i ka ikur komisionit për shkaqe teknike, si dhe projektligjin në tërësi, sepse mendoj se do të jetë një ligj i mirë që e rregullon këtë fushë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se për këtë projektligj janë të propozuara 105 amendamente. Amendamentet 4 dhe 17 nuk janë mbështetur nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Fjalën e ka kërkuar zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po flas në emër të Komisionit për Legjislacion dhe për ta paraqitur rekomandimin që e ka dhënë komisioni lidhur me defektet, të cilat i ka hasur në këtë projektligj. Por, paraprakisht do të doja që nga përfaqësuesi i komisionit në fjalë apo raportuesi të njoftohemi nëse janë inkorporuar këto vërejtje, apo jo. Nëse jo, atëherë unë do t’i paraqes në mënyrë faktike, kronologjike, në cilat nene, cilat amendamente janë në kundërshtim me ligjet tjera bazike dhe që mendojmë se duhet të jenë të përmirësueshme.

KRYESUESI: Sipas raportit, ne këtu i kemi amendamentet 4 dhe 17 që nuk e kanë marrë mbështetjen e komisionit. Tani rreth atyre mospajtimeve është dashur që ju t’i harmonizoni. Ne do t’i votojmë amendamentet e propozuara, pastaj... tjetër rrugë s’kemi. Zoti Çela, urdhëro!

RAIF ÇELA: Amendamentet të cilat janë kontestuar nga Komisioni për Legjislacion i kemi pasur parasysh dhe i konsiderojmë të qëlluara. Për këtë shkak, formulimi i parë nuk është miratuar, por është marrë vërejtja e Komisionit për Legjislacion, sepse ka qenë e përcaktuar që të

mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale (vrasje, sulm fizik, sulm të integritetit seksual, apo për shkak të rrezikimit të sigurisë në trafik, e tjera...). Si propozim që ka qenë prej Qeverisë, i propozuar në bazë të ligjit slloven, kemi pasur vërejtje prej komisionit dhe kemi hequr dorë prej të gjitha këtyre pikërisht për shkak se nuk është në përputhje me legjislacionin.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po e fillojmë votimin. Me elektronikë i votojmë amendamentet 4 dhe 17. Armend, ke ndonjë vërejtje shtesë? Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Sa i përket amendamentit, i cili ka të bëjë me përcaktimin se kush mund të sanksionohet nga kryerësit e veprave penale, si kriter për udhëheqësin profesional të auto-shkollës, e kuptuam që janë marrë propozimet e Komisionit për Legjislacion, por ajo që mungon dhe që është bazike është diskutuar edhe në grupin parlamentar. Është formulimi i amendamentit të katërt, i cili ka të bëjë me llojet e patentë-shoferëve. Ashtu siç është e përcaktuar me projektligjin në fjalë, kjo lë të kuptohet, apo lë hapësirë të kuptohet, se shteti mund të lëshojë dy lloj patentë-shoferësh: një për lëvizje brenda vendit dhe një për lëvizje jashtë vendit. Për më tepër, për shembull fjalët: “është një patentë-shofer i përkthyer në shumë gjuhë” janë të pakuptimta, sepse do të duhej të caktohet një format me standard ndërkombëtar, që do të vlejë në të gjitha shtetet. Dhe, ky është edhe format, apo ta quaj një standard ndërkombëtar i patentë-shoferëve, që vlen sidomos për Evropën.

KRYESUESI: Për cilin amendament e ke fjalën, Armend? Katër?! Në rregull. Atëherë e dha arsyetimin për amendamentin e katërt, kur ta votojmë, kemi votim elektronik, dhe mund të deklarohe mi nëpërmjet votimit.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë 79 deputetë.

Amendamenti 4. Sërish keni të drejtë të diskutoni, në qoftë se dëshironi, meqenëse nuk ka pajtim ndërmjet të dy... Besoj që ju i harxhuat ato... A dëshiron, Raif? Zoti Çelaj e ka fjalën edhe një herë.

RAIF ÇELAJ: Lidhur me përkufizimin “patentë-shofer ndërkombëtar”, komisioni është unanim dhe mendon se duhet të mbetet kështu, siç e ka propozuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e nuk është me bazë vërejtja e Komisionit për Legjislacion, për arsye se duhet të jetë kështu; “Dokument identiteti, i cili mundëson mbajtësit të tij, që ta drejtojë automjetin jashtë shtetit që e lëshon këtë dokument. Është një patentë-shofer i përkthyer

në shumë gjuhë, që ka fotografi të drejtuesit të automjetit dhe të dhëna relevante mbi të drejtën për drejtim”.

Kështu na kanë thënë se është e rregulluar kjo çështje edhe tjetërkund, prej ministrisë, e verifikuar edhe një herë. Edhe pasi ne kemi bërë vërejtje, edhe një herë e kanë verifikuar se është kështu, prandaj si komision, pavarësisht se nuk është e përkrahur prej Komisionit për Legjislacion, mendojmë se duhet të shkojë kështu siç është.

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo praktikë ka qenë para një 30 vjetësh. Zoti Zemaj, ke dëshirë të flasësh? Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues!

Unë e kuptoj logjikën mbi bazën e së cilës kanë punuar, sepse kanë marrë edhe modele dhe kjo i takon ligjit të vjetër. Ajo që po kërkojmë, sepse ky është standard i ri, ky do të kërkohet edhe në të ardhmen. Nëse ne e lëmë kështu, në të ardhmen do të paraqes probleme. Edhe sot, dokumentet e udhëtimit lëshohen në të tri gjuhët dhe ne e kemi edhe shembullin e patentë-shoferit të tanishëm dhe nuk ka nevojë që të jenë dy dokumente udhëtimi. Kjo është një kosto shtesë, e maltreton qytetarin dhe mbi të gjitha krijon edhe mundësi për manipulime.

KRYETARI: Atëherë, përgatitemi për votim. Amendament 4, edhe një herë po e përsëris, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion, Mandate e Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

(Ndërhyrje)

Amendamentin 4, kush e ka lexuar e voton, kush s’e ka lexuar...

Amendamenti 4 është pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Nuk do ta votojmë dy herë të njëjtin amendament.

Ani, le ta riformulojnë! A unë duhet ta riformuloj, a?! Urdhëro, zoti Adem!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe unë jam dakord me propozimin që e dha zoti Zemaj, se ne duhet të ecim përpara, e nuk duhet të kthehemi prapa. Por, unë mendoj se është e domosdoshme që ky amendament të shkojë në lexim të tretë, të korrigjohet dhe të na vijë në Parlament edhe një herë dhe kështu ta zgjidhim këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë duhet shtyrë krejt ligjin, në qoftë se ka pajtueshmëri ndërmjet grupeve parlamentare.

(Ndërhyrje)

Zoti Zemaj, urdhëroni!

ARMEND ZEMAJ: Kryesues!

Ne në Kuvendin e Kosovës funksionojmë me komisionet kryesore dhe komisionet funksionale. Pa dashur të hyj në interpretim të thellë të Rregullores së Kuvendit, amendamentet dhe vërejtjet të cilat i jep Komisioni për Legjislacion, Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Kthim dhe Komunitete, duhet të jenë referencë e pakthyeshme, sepse ne e shqyrtojmë bazën juridike dhe kushtetuese për të gjithë legjislacionin.

Kjo vlen për të gjitha ligjet. Nuk ka të bëjë këtu me mendime personale.

Ky projektligj ka edhe defekte të tjera dhe ne i kemi dhënë këtu, e unë tash e pashë se 90% të tyre nuk janë përfshirë, e të cilat bien në kundërshtim me ligjet bazike.

I keni amendamentet 17, 20, 22, 25, 28, 29, 30, 36, 45, 49, 50, 92, 94 dhe 95. Andaj, arsyeja e plotë është që ky projektligj të shkojë në lexim të tretë, të përmirësohen këto dhe unë po flas vetëm për bazën juridike dhe kushtetuese, pa hyrë në interpretime apo rregullimin e kësaj fushe, e cila është kompetencë e këtij komisioni dhe e dikasterit qeveritar të Ministrisë së Infrastrukturës.

KRYESUESI: Në rregull! Edhe unë e vë në votim që të shkojë në lexim të tretë.

Pra, e kemi një votim formal.

Kush është për? Shumica absolute janë për propozimin.

Atëherë konstatoj që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentë-shofer të shkojë në lexim të tretë dhe të vijë në rishqyrtim në Parlament.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin Naser Osmani, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Osmani, e keni fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe e ka amendamentuar kërkesën apo petitionin e qytetarëve lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike, që ka të bëjë me njohjen e kompensimit të dëmeve joekonomike apo jomateriale, që përfshin, ndër të tjera, shqetësimin mendor, dhimbjen dhe vuajtjen, që është në frymën e parimeve të Kushtetutës së Kosovës për respektimin e të drejtave të njeriut si të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, si dhe detyrimet karshi ligjeve ndërkombëtare. Kompensimi i dëmeve joekonomike është i rregulluar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Po ashtu, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 62, paragrafi 1.4, parashihet që i dëmtuari ka të drejtë në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata për dënimin material, fizik dhe emocional prej të pandehurit që është shpallur fajtor, si dhe me Ligjin për marrëdhëniet detyimore, respektivisht me nenin 183, paragrafi 1, rregullohet çështja e shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial.

Meqenëse e kemi dërguar në Ministrinë e Financave që të mund ta bëjmë përlllogaritjen e kostos buxhetore dhe një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur për shkak të specifikave të ndryshme, ne si komision e kemi paraparë amendamentimin, të cilin ia kemi rekomanduar Kuvendit, është i përshtatshëm për t'u votuar nga deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ky projektligj ka vetëm 2 amendamente dhe votojmë tani.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të tekstit në tërësi. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 05/F-7 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, 04/L-194 dhe 05/L-063.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-31 për procedurën e përgjithshme administrative

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin Sadri Ferati, si raportues i Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Ferati, e keni fjalën!

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të gjithë!

Komisioni Funkcional për Administratë Shtetërore, Pushtet Lokal dhe për Medie e ka shqyrtuar dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e punës të Ligjit për procedurë administrative në bashkëpunim edhe me Ministrinë dhe ekspertët që kanë qenë të angazhuar dhe pas një pune voluminoze, e ka shqyrtuar në detaje çdo amendament dhe të njëjtin ia propozon Kuvendit për miratim.

Ka pasur diskutime të gjata dhe bashkëpunim edhe me komisionet e tjera dhe që në leximin e parë vërejtja kryesore ka qenë rreth përkufizimeve, por ai është i përpunuar në detaje sa që nuk ka pasur nevojë për kufizime dhe si të tillë e kemi propozuar për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë vazhdojmë me votimin, meqë janë 44 amendamente.

Fjalën e ka zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu, edhe në këtë projektligj, vërejtjet janë të theksuara, e të cilat janë dhënë nga Komisioni për Legjislacion.

Unë propozoj që edhe ky projektligj të shkojë për lexim të tretë dhe të eliminohen këto dykuptimësitë që kanë qenë, e para. Dhe e dyta, kemi të bëjmë edhe me rregullativën ligjore, apo me hartimin e legjislacionit, sidomos në udhëzimin administrativ që e kemi për hartimin e ligjeve në Republikën e Kosovës.

Nëse Kuvendi dëshiron, unë mund ta lexoj rekomandimin dhe arsyetimin në tërësi pse ne kërkojmë që të rregullohen shumë norma të saj dhe të cilat bien ndesh edhe me ligjet për konflikte administrative, por edhe me vetë dykuptimësitë që i ka ky projektligj dhe i cili, për mendimin tonë shumë të bazuar, shumë shpejt duhet të vijë në plotësim-ndryshim, sepse do të lë apo do të krijojë zbrazëtira ligjore, të cilat janë të paimplementueshme në praktikë.

Nëse Kuvendi ka durimin, unë po e lexoj edhe arsyetimin, ose po i paraqes vetëm dy-tri pikat kryesore, ku ne kemi hasur në shkelje të rregullativave aktuale ligjore, të cilat konsiderohen si parime në procedurën administrative.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne i kemi shkresat dhe unë kisha kërkuar prej komisioneve që kur t'i marrin vendimet t'i kenë të qarta edhe për seancë, se deklarimi i komisionit tuaj është që projektligji të mos miratohet, por jo të shtyhet për lexim të tretë.

Megjithatë, unë propozimin e hedh në votim, është i arsyeshëm.

(Ndërrhyrje)

Po, për lexim të tretë! Për propozimin që të shkojë në lexim të tretë, unë fillimisht po i pyes grupet parlamentare sipas rregullit dhe votojmë pastaj.

Zoti Grabovci, a jeni dakord me propozimin e zotit Zemaj, respektivisht të Komisionit për Legjislacion?

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është dakord që ky ligj duhet të shkojë në lexim të tretë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, apo zoti Arben Gashi?

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në fakt, nuk propozoi kështu, e ju e formuluat saktë. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, duke parë se ka probleme ndërmjet dy komisioneve, atëherë edhe problemet janë substanciale lidhur me ligjin dhe konceptin e tij, prandaj ne e përkrahim që ligji të shkojë në lexim të tretë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare, Lista serbe nuk është paraqitur. “6+” nuk është paraqitur.

Atëherë, edhe këtë propozim e hedh në votim që sipas deklarimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit të Komisionit për Legjislacion, të shkojë në lexim të tretë dhe të harmonizohen qëndrimet ndërmjet komisioneve parlamentare.

Në sallë janë 76 deputetë dhe votojmë tash për të shkuar në lexim të tretë.

Kush është për? Faleminderit!

Kundër, a ka? 2 vota janë kundër.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi edhe këtë propozim të komisionit dhe grupeve parlamentare që Projektligji për procedurën e përgjithshme administrative të shkojë në lexim të tretë dhe çështjet të harmonizohen.

Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*